



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



PROKURORIA THEMELORE MITROVICË/
OSNOVNO TUŽILAŠTVO U MITROVICI/ BASIC PROSECUTION IN MITROVICA



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË MITROVICË

Janar – Mars 2025

Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, për periudhën kohore Janar-Mars 2025

U.D. Kryeprokurori Rexha pret në takim udhëheqës të Shërbimit Korrektues të Kosovës

Mitrovicë, 15 janar 2025

U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Njazi Rexha ka pritur në takim udhëheqës të Shërbimit Korrektues të Kosovës të prirë nga Besar Gashi, U.D. Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm për Operativë dhe Siguri i SHKK me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit janë diskutuar çështje të ndryshme të bashkëpunimit në mes të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe sfidat e ndryshme të punës.

Në fund të takimit u dakordua që të realizohen takime të vazhdueshme në mes të dy institucioneve, si dhe bashkëpunimi i deritashëm të vazhdojë edhe më tej.



U.D. Kryeprokurori Rexha pret në takim pjesëtarë të KFOR amerikan

Mitrovicë, 24 janar 2025

U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Njazi Rexha ka pritur në takim pjesëtarë të KFOR amerikan të udhëhequr nga Kapitenja Laura Eckstein bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit janë diskutuar çështje të ndryshme të bashkëpunimit në mes të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe sfidat e ndryshme të punës.

Në fund të takimit u dakordua që të realizohen takime të vazhdueshme në mes të dy institucioneve, si dhe bashkëpunimi i deritashëm të vazhdojë edhe më tej.



Kërkesë për caktim paraburgimi për vrasjen e rëndë në Skenderaj

Mitrovicë, 14 shkurt 2025

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për të pandehurit H.I., dhe B.I., pasi ekziston dyshimi i bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale “Vrasje e rëndë” nga neni 173 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 e lidhur me nenin 31, si dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datë 12 shkurt 2025 në një lokal në sheshin “Adem Jashari” në Skenderaj, të pandehurit, së bashku e të vetëdijshtëm për veprimet e tyre, me dashje e privojnë nga jeta tani të ndjerin I.I., ashtu që derisa viktima ishte duke pirë kafe në lokal, të pandehurit posa hyjnë në lokal i nxjerrin armët dhe shtijnë në drejtim të ndjerit I.I., dhe goditjet rezultojnë vdekjeprurëse për të ndjerin.

Të pandehurit, me aktvendim të prokurorit të shtetit gjenden në ndalim nga data 12 shkurt 2025.

Seanca dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve pritet të mbahet pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.



Prokuroria Themelore në Mitrovicë mban takim në kuadër të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026

Mitrovicë, 14 mars 2025

Prokurorët e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Fetije Bajrami - Koordinatore për rastet kundër trafikimit me qenie njerëzore si dhe Shpëtim Peci - Koordinator për veprat penale kundër integritetit seksual, kanë mbajtur takim me akterët të cilët merren me rastet kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe veprat penale kundër integritetit seksual, të regjionit të Mitrovicës.

Pjesëmarrës në takim po ashtu kanë qenë policët hetues të stacioneve policore Mitrovicë Jug, Mitrovicë – Veri, Vushtrri dhe Skenderaj, përfaqësues të Qendrave për Punë Sociale në Mitrovicë dhe Skenderaj, si dhe mbrojtësit e viktimave.

Gjatë takimit janë diskutuar çështjet e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022-2026, bashkëpunimi mes të gjithë akterëve dhe trajtimi i rasteve të trafikimit me njerëz, sfidat dhe pengesat që paraqiten në trajtimin e këtyre rasteve, parandalimi i trafikimit me njerëz, përmirësimi i identifikimit mbrojtjes dhe ri integritetit të viktimave të trafikimit, hetimi penal i rasteve me trafikim me qenie njerëzore në përgjithësi, dhe veprave penale kundër integritetit seksual në veçanti.

Në fund të takimit është vendosur që të mbahen takime të rregullta koordinuese.



Aktakuzë për personin që iu gjet arsenal armësh në Leposaviq

Mitrovicë, 19 mars 2025

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega Leposaviq, kundër të pandehurit R.M., në drejtim të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prokuroria njofton opinionin se i pandehuri R.M., më 31 tetor 2024, në fshatin Soqanicë të komunës Leposaviq, me dashje dhe në kundërshtim me ligjin ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armë pa leje të organit kompetent – pushkë të gjuetisë dhe gjashtëmbëdhjetë (16) fishekë të armës së gjuetisë.

Ndërsa, të pandehurit në shtëpi i janë gjetur dhe sekuestruar:

- Një (1) pushkë gjysëm automatike,
- Një (1) pushkë automatike,
- Një (1) pushkë ajrore,
- Një (1) gaz maskë ushtarake,
- Pesë (5) thika të ndryshme,
- Dy (2) kapela të policisë serbe,
- Njëzetë (20) fishekë të vendosura në fotrolla ushtarake,
- Nëntëdhjetë (90) fishekë të kalibrave të ndryshëm,
- Një (1) palë dylbi të pushkës,
- Një (1) bajonetë pushke,
- Një (1) shufër metalike të policisë,
- Tetëdhjetë e shtatë fishekë (87) të pushkës së gjuetisë,
- Një (1) radiolidhje,
-

Prokurori i Shtetit, i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpallë fajtorë për veprën e kryer penale dhe ta dënojë sipas ligjit.

Komunikatë e përbashkët nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë dhe Policia e Kosovës - Realizohet operacioni policor në 21 lokacione dhe arrestohen disa persona

Mitrovicë, 20 mars 2025

Prokuroria Themelore në Mitrovicë në koordinim me Policinë e Kosovës, respektivisht Drejtorinë për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, të mbështetura nga njësi relevante policore dhe Inspektorati Policor i Kosovës, me datën 19.03.2025, pas hetimeve disa mujore, ka bërë realizimin e urdhëresës së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ku janë kontrolluar gjithsej 21 lokacione në Mitrovicë Jugu, Mitrovicë Veri, Vushtrri, Skenderaj dhe Leposaviq.

Nga ky operacion policor janë shoqëruar në Polici gjithsej 16 persona lidhur me dyshimin e kryerjes së veprave penale 'detyrim' si dhe 'importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse'.

Si dëshmi materiale gjatë kontrollit janë sekuestruar 9 armë zjarri, 200 fishekë, municione të ndryshme, 15 telefona mobilë, 2 palë pranga, thikë, tyta të armës, fatrolla për armë dhe 1 DVR.

Pas intervistimit lidhur me rastin, me vendim të prokurorit, 13 persona shkojnë në ndalim prej 48 orësh.



Kërkesë për caktimin e paraburgimit për tetë personat e arrestuar në aksionin e datës 19 mars në regjionin e Mitrovicës

Mitrovicë, 20 mars 2025

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë caktimin e paraburgimit për tetë (8) personat e arrestuar me datë 19 mars në Mitrovicë, në aksionin e realizuar në gjithsej 21 lokacione në regjionin e Mitrovicës, në të cilin u sekuestruan 9 armë zjarri, 200 fishekë, municione të ndryshme, 15 telefona mobilë, 2 palë pranga, thikë, tyta të armës, fatrolla për armë dhe 1 DVR.

Për të pandehurit B.H., I.P., dhe O.B., është paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për shkak të dyshimit se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale "Detyrimi" nga neni 328 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi ,këmbimi ,ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo material plasëse nga" neni 364 paragrafi 1 lidhur neni 31 të KPRK-së,

Për të pandehurit A.S., T.R., A.B., Sh.S., dhe N.R., është paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale "Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi ,këmbimi ,ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo material plasëse" nga neni 364 paragrafi 1 lidhur neni 31 të KPRK-së,

Seanca për caktimin e paraburgimit për tetë të akuzuarit do të mbahet ditën e sotme, datë 20 mars 2025.



Aktakuzë kundër zyrtarëve që u zunë duke konsumuar kokainë në komunën e Leposaviqit

Mitrovicë, 21 mars 2025


Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ndaj të pandehurit me initiale S.S., për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, si dhe ndaj D.M., dhe S.M., për shkak të dyshimit për kryerjen e veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”.

Gjatë muajit nëntor 2023 në objektin e Komunës së Leposaviqit, i pandehuri S.S., akuzohet se në objektin e komunës së Leposaviqit në një nga zyrat e komunës e fton të pandehurën D.M., dhe i ofron substancë narkotike të llojit kokainë dhe e konsumojnë së bashku përmes hundës,

Po ashtu, në një rast tjetër në muajin nëntor 2023, i pandehuri S.S., e thërret në një nga zyrat e objektit të Komunës së Leposaviqit të pandehurin S.M., dhe i ofron substancë narkotike kokainë të cilën e vendos në tavolinë dhe i pandehuri S.M., e konsumon përmes hundës,

Po ashtu, gjatë muajit nëntor i pandehuri S.S., në një nga lokalet e qytetit pa autorizim shpërndanë substanca narkotike të llojit kokainë, ashtu që e thërret në banjon e kafiterisë të pandehurën D.M dhe i ofron substancë narkotike kokainë të cilën e pandehura D.M., e konsumon përmes hundës.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë me rastin e ngritjes së aktakuzës ka kërkuar nga gjykata që tre (3) të pandehurit të i shpallë fajtorë për veprat e kryera penale dhe ti dënojë sipas ligjit.



Kërkesë për caktimin e paraburgimit për vrasjen e rëndë në Vushtri

Mitrovicë, 24 mars 2025

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë caktimin e paraburgimit për të pandehurin me initiale B.D., për shkak të dyshimit për kryerjen e veprave penale "Vrasja e rëndë" nga neni 173 par.1 nën par.1.5 të KPRK-së, si dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I pandehuri B.D., me datë 23 mars 2025 rreth orës 20:30 minuta në rrugën "Galip Badivuku" në Vushtri, me dashje e privon nga jeta viktimën me initiale A.Z., ashtu që me armën e zjarrit tip pistoletë, e gjuan dhe e godet së paku tri (3) herë në trup, ku viktimë si pasojë e plagëve të marra nga arma e zjarrit ndërron jetë në Repartin e Emergjencës në Spitalin e Vushtrisë.

I pandehuri gjatë marrjes në pyetje e ka pranuar kryerjen e veprës penale.

Seanca për caktimin e paraburgimit për të pandehurin do të mbahet pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Një e vrarë dhe një i vetë vrarë në Stanoc të Vushtrrisë

Mitrovicë, 24 mars 2025

Si pasojë e te shtënave dy persona kanë mbetur të vdekur në fshatin Stanoc të Vushtrrisë.

Dyshohet se një burrë fillimisht e ka privuar nga jeta një grua, dhe pastaj ka bërë vetëvrasje.

Në vendngjarje ka dalur prokurori kujdestar i PTH Mitrovicë.

Në vendngjarje janë gjetur disa gëzhoja që dyshohet se janë përdorur në këtë krim.

Janë duke u intervistuar dëshmitarë dhe në koordinim me policinë janë duke u hetuar të gjitha rrethanat që kanë quar në këtë ngjarje të rëndë.

Takim mbi trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë

Mitrovicë, 25 mars 2025

Me qëllim të diskutimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, me iniciativë të Koordinatorës për rastet e dhunës në familje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit Laura Pula dhe Koordinatorit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave Burhan Maxhuni, sot u mbajt një takim në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Pjesëmarrës në takim ishin U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Njazi Rexha, prokurorja – koordinatorë për rastet e dhunës në familje, Ajtene Zoni dhe stafi i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave.

Ky takim u fokusua në adresimin e sfidave aktuale në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje, si dhe në përmirësimin e mbështetjes për rastet e viktimave të krimit përmes masave mbrojtëse dhe ndihmës së specializuar.

Koordinatorja për rastet e dhunës në familje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit Laura Pula theksoi rëndësinë e një qasjeje të unifikuar mes institucioneve për të garantuar trajtim të shpejtë dhe efikas të rasteve, duke siguruar mbrojtjen e viktimave dhe ndëshkimin e autorëve të dhunës.

Koordinatori i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave Burhan Maxhuni vuri në pah nevojën për mbështetje të vazhdueshme psiko-sociale dhe ligjore për viktimat e krimit , si dhe rëndësinë e zbatimit efektiv të masave mbrojtëse për të parandaluar rastet e përsëritura të dhunës.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë U.D. Njazi Rexha konfirmoi angazhimin e institucionit për trajtimin me prioritet të këtyre rasteve, duke theksuar rëndësinë e koordinimit mes prokurorisë, policisë dhe institucioneve mbështetëse për të siguruar një sistem më efikas dhe të drejtë për viktimat e dhunës në familje.

Në përfundim të takimit, palët u akorduan për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërmarrjen e hapave konkretë për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe ndëshkimit të dhunës në familje.

